


Statistikat e Blegtorisë, 2021

Tiranë, më 27 Qershor 2022: Numri i gjedhëve në vitin 2021, është 336.784 krerë.

Fig. 1 Struktura e blegtorisë në njësi gjedhi sipas kategorive kryesore 2021, (%)



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në vitin 2021, numri i të leshtave është 1,48 milionë krerë. Kategoria kryesore e të leshtave përbëhet nga delet e qumështit me rreth 75,38% ndaj numrit gjithsej të tufës.

Numri i të dhirtave në vitin 2021, është 775.337 krerë. Kategoria kryesore përfaqësohet nga dhitë e qumështit me 77,26 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Në vitin 2021, numri i krerëve të derrave është 159.237 krerë.


Për publikim 27/06/2022

Tab. 1 Numri i krerëve të blegtorisë, (mijë krerë)

Emërtimi	2017	2018	2019	2020	2021
Gjdhë	475	467	416	363	337
Lopë	349	343	316	289	278
Të leshta	1.925	1.864	1.758	1.558	1.480
- Dele	1.407	1.366	1.297	1.174	1.116
Të dhirta	933	917	863	774	775
- Dhi	717	699	671	619	599
Derra	180	184	184	158	159
- Dosa	12	12	14	12	12
Njëthundrakë	89	88	87	79	76
- Kuaj	32	32	32	30	29
Shpendë	7.835	8.362	8.179	7.907	7.652
- Pula	4.820	4.963	5.004	5.001	5.249
Bletë/koshere	290	285	288	358	394

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Prodhimi i qumështit në vitin 2021 është 1,01 milionë tonë. Struktura e prodhimit të qumështit, referuar vitit 2021 është: qumësht lope 84,83 %, qumësht dhie 7,9 1% dhe qumësht dele me 7,25 %.

Fig. 2 Prodhimet blegtorale 2020 – 2021, (mijë tonë)

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në 2021, prodhimi i qumështit nga lopët është 859.381 tonë. Rendimenti mesatar vjetor i qumështit në nivel vendi në 2021, është 3.055 kg për krerë.

Prodhimi qumështit nga delet për vitin 2021, është 73.466 tonë. Rendimenti mesatar vjetor, në nivel vendi i qumështit të deles është 63 kg për krerë.

Prodhimi qumështit nga dhitë në 2021, është 80.173 tonë. Rendimenti mesatar vjetor i qumështit nga dhitë në nivel vendi është rreth 128 kg për krerë.

Prodhimi i mishit peshë e gjallë është 148 mijë tonë, ndërsa prodhimi i vezëve për vitin 2021 është 899 milionë kokrra. Nga ana tjetër prodhimi i mjaltit për vitin 2021 është 4.835 tonë.

Tab. 2 Prodhimet blegtorale, (tonë)

Emërtimi	2017	2018	2019	2020	2021
Qumësht	1.156.286	1.144.353	1.112.196	1.052.192	1.013.020
Mish peshë e gjallë	161.286	161.373	156.643	150.353	148.169
Vezë/milionë kokrra	811	828	865	861	899
Mjaltë	3.614	3.937	4.116	4.599	4.835

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Numri i krerëve të blegtorisë sipas qarqeve, 2021

Qarqet më përfaqësues lidhur me mbarështimin e gjedhit për vitin 2021, janë Fieri me 17,25 % dhe Korça me 11,13 % ndaj numrit gjithsej të gjedhëve.

Përqendrimi më i madh i numrit të të leshtave është në qarkun e Vlorës me 23,74 % dhe në qarkun e Korçës me 16,51 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.


Përqendrimi më i madh i numrit të të dhirtave është në qarkun e Vlorës me 20,93 % dhe në qarkun e Gjirokastrës me 11,99 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Përqendrimi më i madh i numrit të derrave është në qarkun Lezhë me 35,67 % dhe në qarkun Fier me 19,31 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Tab. 3 Numri i krerëve të blegtorisë sipas qarqeve 2021, (mijë krerë)

Qarku	Gjedhë	Të leshta	Të dhirta	Derra	Njëthundrakë	Shpendë	Koshë bletë
Berat	15,6	121,0	73,2	2,9	7,6	627,2	20,5
Dibër	27,4	70,0	40,3	2,9	6,7	296,0	28,3
Durrës	19,0	27,6	21,1	7,1	2,1	1.486,8	13,0
Elbasan	29,5	100,3	71,5	6,6	9,7	877,5	29,6
Fier	58,1	224,3	42,8	30,8	8,3	1.597,4	28,6
Gjirokastrë	11,6	169,0	93,0	0,9	5,6	165,5	28,0
Korçë	37,5	244,4	89,6	9,6	13,9	490,8	60,0
Kukës	28,0	37,8	23,5	0,7	3,9	103,1	41,4
Lezhë	20,8	27,3	51,1	56,8	1,2	287,9	22,8
Shkodër	29,5	52,2	58,5	29,4	3,7	637,2	59,0
Tiranë	36,3	55,1	48,5	1,7	5,4	628,4	34,5
Vlorë	23,4	351,5	162,3	9,9	7,5	453,8	27,9
Gjithsej	336,8	1.480,5	775,3	159,2	75,6	7.651,6	393,6

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Fig. 3 Struktura e blegtorisë në njësi gjedhi sipas qarqeve 2021, (%)

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Metodologjia

Statistikat e blegtorisë për vitin 2021, mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave blegtorisë dhe prodhimeve blegtorale mbështeten në Programin e Statistikave Zyrtare, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Informacioni mbledhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Të dhënat blegtorale grumbullohen për numrin e kafshëve që mbarështojnë fermerët si dhe prodhimet blegtorale. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë të dhëna për ti krahasuar dhe me të dhënat e shërbimit veterinar i cili kryen matrikullimin dhe vaksinimin e kafshëve (proçesi është në vazhdimësi). Shërbimi veterinar kryen në momentin e vaksinimit inventarin e kafshëve në nivel komune. Specialistët e ekstensionit kanë marrëdhënie dhe me veterinerët privatë. Këta veterinerë kryejnë shërbime të ndryshme në mënyrë private pranë fermerëve (si kontroll nga sëmundjet, ngordhje të kafshëve apo lindje, therje, vaksinime etj). Në fund specialistët e ekstensionit krahasojnë të dhënat nga të tre burimet. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë gjithashtu të dhëna për prodhimet bujqësore dhe blegtorale nga fermerët. Të dhëna për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel komune. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit blegtoral bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.

Ministria e Bujqësisë përdor tre burime informacioni për grumbullimin e të dhënave:

1. Ekspertët e ekstensionit që janë pjesë e strukturave të Drejtorive të Bujqësisë
2. Shërbimin veterinar
3. Veterinerët privat

Përkufizime

Njësia Ekonomike Bujqësore (NJEB) - është njësi e vetme, teknike ekonomike, e përcaktuar në një drejtim unik, nga terreni dhe pse në parcela jo të vazhdueshme, në të cilën realizohet prodhimi bujqësor dhe blegtoral që drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, për realizimin e veprimtarive bujqësore – blegtorale.

Njësi ekonomike bujqësore konsiderohen edhe njësitë ekonomike me drejtim të plotë blegtoral, në të cilat arrihet mbarështimi i kafshëve pa pasur në administrim tokë bujqësore, pra ku toka nuk figuron si element përbërës i njësisë.

Njësia e gjedhit - Njësia e gjedhit, e shkurtuar si LSU (Livestock Unit), është një njësi referimi që lehtëson agregimin dhe krahasimin e bagëtive nga specie dhe mosha të ndryshme, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve specifikë të vendosur fillimisht në bazë të kërkesave ushqimore për çdo lloj kafshe. Njësia referencë e përdorur për llogaritjen e njësive blegtorale (=1 LSU) është ekuivalenti i një lope për qumësht që prodhon 3 000 kg qumësht në vit, pa ushqime shtesë të koncentruar.

Blegtoria dhe shpendët mbulojnë të gjitha kafshët pavarësisht nga mosha e tyre vendndodhja ose qëllimi i tyre për mbarështim. Kafshët mund të jenë prezent në Njësinë Ekonomike Bujqësore, ose jashtë fermave bujqësore në kullotë.

Klasifikimi

Klasifikimi i kafshëve bëhet sipas llojeve (gjedhë, të leshta, të dhirta, derra, kuaj), sipas moshës, seksit dhe destinacionit ekonomik.

Shpendët janë të grupuar në një grup të vetëm dhe përfshihen pulat, pulat afrikane, gjela deti, pata, rosa, etj.

Prodhim mishi peshë e gjallë

Vlerësimi për prodhimin e mishit peshë e gjallë kryhet për çdo lloj kafshe. Llogaritja e prodhimit të mishit peshë e gjallë bazohet në përlogaritjet e bëra nga lëvizja e blegtorisë, pra në numrin e krerëve të skartuar për gjedhë, të leshta, të dhirta, derra dhe shpendë, sipas kategorive të therjes, dhe në peshën e gjallë mesatare për krerë të therur sipas llojeve dhe kategorive të therjes.

Rregullat kryesore për grumbullimin e të dhënave

Numri i krerëve të blegtorisë i referohet datës 1 Dhjetor 2021.

Fermeri pyetet për të gjitha llojet e kafshëve që ai zotëron.

Informacioni grumbullohet vetëm për numrin e krerëve që ka në zotërim njësia ekonomike bujqësore

Të gjitha kafshët e blera nga ekonomi të tjera gjatë vitit numërohen.

Të gjitha kafshët e shitura ekonomive të tjera gjatë vitit nuk numërohen.

Lindjet e blegtorisë janë të lindurit gjatë 12 muajve të fundit. Nuk përfshihet blegtoria lindur e ngordhur.

Humbjet e kafshëve gjatë vitit, ngordhje, ngrënie nga egërsirat, apo nga shkaqe natyrore nuk numërohen.